

Emri i Lëndës : Programim në Web							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
EMS 219	B	Vjeshtë	2.00	2.00	0.00	3.00	5.00
Lektori		Grasiela Baçellari, Msc					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Anglisht					
Niveli i lëndës		Bachelor					
Përshkrimi		Ky kurs është një pasqyrë e teknologjive moderne të Webit. Objektivi i këtij kursi është tu ofrojë studentëve njohuri bazë mbi funksionimin e rregullave në botën e Webit nga ana teknologjike si dhe një përmbledhje bazë të teknologjive të ndryshme. Ideja e këtij kursi është që studentet të mësojnë të përdorin teknologjitë front-end, si dhe t'i ndihmojë ata në të kuptuarin e bazave thelbësore të zhvillimit të webit. Disa nga temat kryesore përfshijnë: Historia e Webit, si funksionon Webi, modeli klient-server në web, konceptet kryesore të ndërtimit të një faqe webi, Hypertext Markup Language (HTML), Cascading Style Sheets (CSS), JavaScript si dhe libreria JQuery, etj.					
Objektivat		Ky kurs synon që studentët të: 1. Kuptojnë funksionimin e web-it si dhe rolet kryesore të nevojshme për ndërtimin e tij. 2. Jenë të gatshëm të bëjnë diferencën e duhur mbi zhvillimin front-end dhe back-end të webit. 3. Dinë të markojnë një tekst në gjuhën HTML 4. Jenë të aftë të ndërtojnë një faqe webi me të gjithë elementët e nevojshëm front-end me gjuhët HTML dhe CSS.					
Konceptet Kryesore		1. HTTP 2. WWW, W3C 3. URL 4. Zhvillimi Front-end dhe Back-end 5. Modeli Klient-Server 6. HTML, CSS, JavaScript					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Historia e webit. Si funksionon Webi, ndryshimi midis internetit dhe webit, adresat URL dhe pjesët përbërëse të saj, modeli klient-server në kërkimin e një informacioni në web. (Learning Web Design O'Reilly fq.21-40)						
2	Ndërtuesit e një faqe webi, çfarë përfshin çdo rol i formimit të një site. Trajtimi i koncepteve bazë si dhe rolet kryesore të zhvillimit të një website si: Strategjist i përmbajtjes, Arkitekti i informacionit, zhvilluesit UI, diagramat e website-it, dizenjimi vizual, zhvillimi Front-end dhe Back-end i një website. Struktura HTML, çfare është një dokument HTML, taget dhe llojet e tyre, ndarja e dokumentit në pjesë të caktuara si head, body, paragraf, etj. (Learning Web Design O'Reilly fq.4-12 dhe fq.49-60)						
3	Si bëhet markimi i një teksti, elementët e ndryshme HTML. Imazhet dhe mënyra e implementimit të tyre në një faqe webi, Rregullimi i tyre nëpërmjet atributëve shtesë si dhe shtimi i borderave të imazheve. Ndryshimi i madhësisë si dhe pozicionimi i tyre në disa pozicione bazë. (Learning Web Design O'Reilly fq.79-105; HTML & CSS John Duckett fq.41-58)						
4	Linqet. Kalimi nga një faqe në tjetrën nëpërmjet linqeve, si dhe kalimi nga një pjesë e faqes së webit në një pjesë tjetër, përdorimi praktik i tyre brenda një faqe webi. Aplikimi i hiperlinqeve mbi tekste dhe imazhe. (HTML & CSS John Duckett fq.74-93; Learning Web Design O'Reilly fq.113-128)						
5	Tabelat. Implementimi i tabelave për të shfaqur të dhëna të strukturuar. Rregullimi i tyre sipas nevojës së faqes së webit. (HTML & CSS John Duckett fq.27-143; Learning Web Design O'Reilly fq.163-173)						
6	Listat dhe formularët. Listat e renditura dhe të parenditura, implementimi i tyre. Llojet e ndryshme të formularëve si: text, checkbox, submit button, etj, dhe përdorimi specifik i secilit lloj. (HTML & CSS John Duckett fq.62-73 dhe fq.144-175; Learning Web Design O'Reilly fq.177-206)						

7	Hyrje ne CSS (Cascading Style Sheets). Në këtë temë do të trajtohet sintaksa e CSS dhe ndërveprimi i saj me HTML; llojet e CSS dhe aplikimi i secilës prej tyre; selektorët dhe përdorimi i tyre. (HTML & CSS John Duckett fq.226-245; Learning Web Design O'Reilly fq.239-259)
8	Provimi gjysëm final
9	Hierarkia e CSS, si dhe radha e aplikimit të rregullave. Ngjyrat dhe sfondi (color mode, përzgjedhja e ngjyrave si dhe përdorimi i tyre nëpërmjet kodit hexadecimal). (HTML & CSS John Duckett fq.246-263; Learning Web Design O'Reilly fq.303-351)
10	Njësitë matëse në CSS, përdorimi dhe ndryshimi midis tyre (px,rem em). Teksti dhe formatimi i tij duke përdorur të gjitha atributet e mundshme të CSS. Stilimi i tekstit ne CSS: font-family, font-size, line- eight, letter-spacing, word-spacing, color, text-decoration, font-style, fontweight,etj. (HTML & CSS John Duckett fq.264-299)
11	Modeli "kuti" (Box model), si aplikohet modeli në elementët përkatës të një faqe webi. Formatimi i imazheve në CSS (HTML & CSS John Duckett fq.300-329 dhe fq.407-427)
12	Layout dhe navigacioni. Orientimi i përgatitjes së një faqe webi. Krijimi i një layout-i efektiv për faqet web, si dhe te implementimi i navigacionit për të ofruar një përvojë të mirë përdoruesi. (HTML & CSS John Duckett fq.358-405; Learning Web Design O'Reilly fq.419-482)
13	Hyrje në Javascript. Hyrje në JavaScript, duke përfshirë funksionet themelore të tij për të shtuar ndërveprim në faqe. Përdorimi i JavaScript për të manipuluar elementet HTML dhe për të krijuar faqe më dinamike. (Learning Web Design O'Reilly fq.593-619;)
14	Javascript dhe sistemi DOM-Document Object Model. Koncepti DOM dhe si mund të përdoret JavaScript për të modifikuar strukturën e dokumentit HTML, duke rritur interaktivitetin e faqes web. (Learning Web Design O'Reilly fq.621-636;)
15	Dorëzimi dhe prezantimi i projekteve. Përsëritje.
16	Provim Final
Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
Literatura	<ul style="list-style-type: none"> • "Learning Web Design: A Beginner's Guide to HTML, CSS, JavaScript, and Web Graphics" by Jennifer Robbins, O'Reilly 2018
Referenca të tjera	<ul style="list-style-type: none"> • "HTML, CSS & JavaScript in easy steps" by Mike McGrath, In Easy Steps 2020 • "HTML and CSS Design and Build Websites" by Jon Duckett, O'Reilly 2011
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studentët do të jenë të aftë të kuptojnë bazat dhe konceptet e teknologjisë së webit.
2	Studentët do të jenë të aftë të ndërtojnë një website të përbërë prej disa faqe web-i e dizenuar me Style sheet dhe JavaScript.
3	Studentët do të jenë të aftë të kuptojnë aplikacionet e web-it nga ana e klientit dhe serverit.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	25	
Kuize	0	0	
Projekte	1	25	
Projekte semestrare	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final		60	
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final		40	
Total		100	
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	2	28
Detyra	1	8	8
Gjysmë finale	1	10	10
Provimi final	1	15	15
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			125
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.00
ECTS			5.00